



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 53

Prishtinë, më 2 prill 2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Berat Buzhala, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi, Petar Miletij.

Pjesëmarrës të tjerë: Mihane Rrahmani, ZRPK-praktikante dhe Besnik Ramadani, KDI/TIK.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Gurjeta Zeka, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
3. Të ndryshme;
4. Takim me delegacionin zviceran të kryesuar nga Sh. S. Maya Graf, kryetare e Këshillit Nacional dhe e Kuvendit Federal të Zvicrës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Kryetari theksoj se anëtarëve të Komisioni, së bashku me procesverbalin, i është shpërndarë edhe transkripti nga mbledhja e mbajtur më 27 shkurt 2013, dhe shënimi zyrtar nga takimi i mbajtur më 11 mars 2013.

Komisioni e miratoi njëzëri procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 27 shkurt 2013.

3. Të ndryshme

Albin Kurti- I njoftoj se në konsultim me anëtarët e Komisionit, mbajtja e tryezës së rrumbullakët rajonale me kryetarët e komisioneve të jashtme të rajonit është shtyrë në kohë të pacaktuar. Shkaku i shtyrjes së tryezës tha se është konfirmimi i pamjaftueshëm nga ana e të ftuarve, kryesisht për shkaqe objektive të ndikuara nga situatat aktuale në vendet e tyre.

Ai, po ashtu, njoftoi se me ftesë të Komisionit për Punë të Jashtme, Kuvendin e Kosovës do ta vizitojë një delegacion i Komisionit për Punë të Jashtme i Kuvendit Kombëtar të Hungarisë. Delegacioni hungarez do të jetë në përbërje prej 4 anëtarësh dhe do të qëndrojë në Kosovë më 10 dhe 11 prill.

Lidhur me Planin e veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Komisioni angazhoi deputetin Hydajet Hyseni, që të shqyrton obligimet të cilat mund t'i ketë Komisioni nga ky plan.

Kryetari njoftoi se me vendimin për plotësimin e Strategjisë legislative për vitin 2013 janë paraparë për shqyrtim edhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

4. Takim me delegacionin zviceran të kryesuar nga Sh. S. Maya Graf, kryetare e Këshillit Nacional dhe e Kuvendit Federal të Zvicrës.

Në takim me Komisionin ishte delegacioni në përbërje prej: Sh.S. Maya Graf – kryetare e Këshillit Nacional dhe e Kuvendit Federal të Zvicrës, SH. S. Krystyna Marty Lang, Ambasadore e Zvicrës në Prishtinë, Z. Ruedi Lustenberger, zëvendëskryetari i Parë i Këshillit Nacional zviceran, Z. Ueli Leuenberger, anëtar i Parlamentit zviceran, Z. Laurent Favre, anëtar i Parlamentit zviceran, Z. Hansjörg Hassler, anëtar i Parlamentit zviceran, Z. Roland Fischer, anëtar i Parlamentit zviceran, Z. Andy Tschümperlin, anëtar i Parlamentit zviceran, Z. Adrian Amstutz, anëtar i Parlamentit zviceran, znj. Suzanne Stritt - Schwegler, Shefe e Protokollit, Asambleja Federale dhe Z. Claudio Fischer, shef i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Asambleja Federale.

Albin Kurti- Fillimisht prezantoi anëtarët e Komisionit. Ai falënderoi shtetin zviceran për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës. Njoftoi për gjendjen e përgjithshme në Kosovë, me theks të veçantë për gjendjen ekonomike dhe për rolin që ka emigracioni në vendet perëndimore për mbijetesën e popullit të Kosovës. Shtetit zviceran tha se i jemi falënderues edhe pas çlirimit të Kosovës, qoftë për trupat e KFOR-it, qoftë për programet e ndryshme zhvillimore në ekonomi, kulturë e arsim. Theksoi se marrëveshja për kthimin e personave pa leje qëndrimi në Zvicër, i dëmton interesat e shtetaseve të Kosovës për arsye se nuk e bën dallim në mes të shtetasve të Kosovës në Zvicër me emigrantët e tjerë. Njëkohësisht theksoi anulimin e njëanshëm nga Zvicra të marrëveshjes së trashëguar ndërshtetërore mbi sigurimet dhe kërkoi që të ketë një rinegocim të kësaj marrëveshjeje.

Maya Graf- prezantoi anëtarët e delegacionit dhe shtoi se problemet lidhur me sigurimet sociale u janë të njohura dhe se duhet të realizohen në mes qeverive të të dyja palëve. Shpreson në gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë, para së gjithash të krijohen parakushtet në mënyrë që të gjitha këto kontribute të kalojnë në fondet e Kosovës.

Ueli Leuenberger -Tha se ka pasur rast që të bisedojë me përfaqësues të parlamentit lidhur me marrëveshjet sociale. Lidhur me këtë çështje tha se ekzistojnë dy probleme, njëri është zviceran, kurse tjetri kosovar, por patjetër duhet të gjendet një zgjidhje sa më shpejt që është e mundur. Sa i përket përmbushjes së kushteve lidhur me marrëveshjen sociale tha se ka përparime të ngadalshme. Shpreson që deputetët, e po ashtu edhe Qeveria e Kosovës do të angazhohen për këtë çështje shumë të rëndësishme për familjet kosovare. Në këtë drejtim tha se jemi të bllokuar dhe as qeveria nuk mund të bëjë asgjë, deri në plotësimin e parakushteve.

Hydajet Hyseni – ndihmën e shtetit zviceran e konsideroi shumë të rëndësishme në përpjekjet e Kosovës për mbijetesë, liri e perspektivë demokratike. Tani tha se na duhet një betejë tjetër, për ta fituar paqen, për ta fituar perspektiven zhvillimore demokratike, sidomos në aspektin ekonomik dhe në sundimin e ligjit. Mërgata jonë në Zvicër tha se ka luajtur rol të rëndësishëm, jo vetëm për mbijetesën tonë, por edhe në transformimet e përgjithshme edhe në evropianizimin e përgjithshëm. Shprehu bindjen se bashkërisht do të përmbyllim me sukses edhe synimet e tjera dhe të justifikojmë përkrahjen të cilën e kemi pasur nga shteti zviceran.

Emilija Rexhepi -. Respektimi i të drejtave të njeriut, i të drejtave të pakicave, përdorimi i gjuhëve zyrtare, tha se është në nivel të lartë në Zvicër dhe një mënyrë të këtillë të rregullimit e kemi edhe ne edhe pse jemi vend i vogël, por kemi ngjashmëri. Shpreson që marrëveshja për sigurimet sociale të përfundoj sa më shpejt që është e mundur.

Donika Kadaj- Bujupi - Kosova nga cilësimi si vend me probleme tha se tanimë duhet të shihet si mundësi për të gjithë ata që janë të gatshëm për bashkëpunim, në kuptimin e investimeve, të bashkëpunimit ekonomik dhe atij politik. Kërkoi përkrahjen e delegacionit lidhur me zgjidhjen e çështjes së pensioneve.

Skender Hyseni -Shqetësim të madh për institucionet e Republikës së Kosovës theksoi mosnjohjen e Republikës së Kosovës nga pesë vende anëtare të BE-së. Kërkoi nga delegacioni zviceran që gjatë komunikimeve të tyre drejtpërdrejta me parlamentet e vendeve që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës, të llobojnë për njohjen e saj. Mosnjohja e Kosovës nga këto vende sikur ka instaluar një politikë të neutralitetit ndaj statusit të Kosovës edhe në institucionet evropiane gjë që po kthehet në një pengesë politike dhe diplomatike në rrugën e Kosovës drejt konsolidimit të plotë ndërkombëtar, e të shtetësisë, tha z. Hyseni.

Hansjörg Hassler –Duke i cilësuar raportet shumë të mira në mes të Kosovës dhe Zvicrës shtoi se janë të interesuar që t'i njohin kushtet që mbizotërojnë në Kosovë. Lidhur me sigurimet pensionale tha se ka vështirësi nga pala zvicerane sepse në Kosovë nuk ekzistojnë regjistrat e plotë të personave. Ai po ashtu ngriti çështjen e riatdhesimit të qytetarëve të Kosovës nga Zvicra.

Adrian Amstutz – Theksoi se në aspektin e sigurimeve sociale ka pasur disa keqpërdorime të cilat duhet të eliminohen. Në interes të qytetarëve të cilët kanë punuar në mënyrë të drejtë, dhe kanë të drejtë të kërkojnë kontributet e tyre sociale dhe pensionale, nevojitet një dialog i hapur dhe transparent. Kërkoj të njoftohet rreth sigurisë në Kosovë, ngase Zvicra tha se akoma ka kërkesa për azil edhe nga Kosova.

Albin Kurti- Theksoi se nuk duhet të përjashtohet mundësia që ka pasur ndonjë keqpërdorim individual të sigurimeve sociale, mirëpo ato nuk duhet të pasohen me dënime kolektive. Varfëria në Kosovë tha se është shumë e përhapur, 45% e popullsisë jetojnë me më pak se dy dollarë në ditë, 18% me më pak se një dollarë në ditë dhe më shumë se gjysma e popullsisë të aftë për punë, janë të papunë. Shteti i Kosovës nuk e ka kontrollin dhe rregullimin e mjaftueshëm për

gjithçka që është e nevojshme për të parandaluar keqpërdorimet e mundshme. Ai tha se mërgata ka qenë mundësia jonë për luftë çlirimtare, pa mërgatën nuk do të kishte luftë çlirimtare kundër Serbisë dhe sot, pa mërgatën nuk ka paqe sociale.

Berat Buzhala – në diskutimin e tij në mes tjerash kërkoi nga delegacioni që të ndikojë tek FIFA që t'i mundësohet Kosovës të ketë ekipin e vet kombëtarë. Imazhi ynë tha se do të përmirësohej shumë me një përfaqësuese që do të luante kundër shteteve tjera. Kërkoi që Kosova të ndihmohet në këtë drejtim edhe për sporte të tjera, jo vetëm në futboll.

Sabri Hamiti –në mes tjerash theksoi se tani Kosovës i nevojitet ndihma, në mënyrë që njerëzit me aktivitetet dhe aftësi të mëdha të mos largohen, por të gjejnë punë në Kosovë. Duke cekur se motivi politik e ai i sigurisë bie në Kosovë, ndërsa ai ekonomik është i përhershëm dhe i shprehur edhe në vendet e tjera, kërkoi që të bëhen investime në mënyrë që fuqia punëtore e intelektuale e Kosovës të strukturohet dhe të punojë në Kosovë.

Hydajet Hyseni- Në një pjesë të Kosovës, mbi lumin Ibër tha se nuk kemi ndryshime pozitive që të themi se nga atje nuk ka arsye sigurie, për të ikur. Nëse vjen dikush nga Kosova dhe vjen nga ajo pjesë, ka arsye për të ikur nga ajo pjesë, sepse atje ai nuk mund të përdorë gjuhën, s'ka të drejtat elementare, s'ka as lirinë e qarkullimit dhe pjesë të tilla nuk ka vetëm në veri, ka edhe në enklava që kanë të njëjtat probleme pothuajse edhe në pjesë tjera të Kosovës. Për më tepër tha se, është edhe problemi i shqiptarëve nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, një pjesë e madhe e të cilëve përballen me presione të mëdha, ndonjëherë identifikohen edhe me Kosovën dhe një pjesë e madhe e tyre kanë ikur në Kosovë.

Ruedi Lustenberger -Situata rreth marrëveshjes sociale tha se duhet të zgjidhet patjetër, që të mos ketë pasoja kolektive. Çështjet të cilat akoma nuk janë sqaruar në mes të dy vendeve duhet të zgjidhen, në mënyrë që njerëzve që i gëzojnë të drejtat e veta për shërbime të tilla, mos t'ju mohohen ato.

Maya Graf – duke u falënderuar në emër të delegacionit për takimin, premtoi se për çështjet e diskutuara lidhur me marrëveshjen rreth sigurimeve sociale, mosnjohja e Kosovës nga pesë vendet e BE-së, kërkesën për liberalizmin e vizave, anëtarësimin e Kosovës në FIFA, do t'i njoftojë deputetë dhe qeverinë zvicerane.

Takimi përfundoi në orën 11:35.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit